

V E N D I M
Nr. 592, datë 2.11.2001

PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË"
PËR PRODHIMIN E VESHJEVE TË STRUKTURAVE USHTARAKE DHE POLICORE PËR
NEVOJAT E MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK ME NDËRMARRJEN E PRODHIMIT TË
VESHJEVE TË USHTRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Ministrisë së Rendit Publik, që për nevojat e veta, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" me Ndërmarrjen e Prodhimit të Veshjeve të Ushtrisë për prodhimin e veshjeve të strukturave ushtarake dhe policore.
 2. Çmimet e blerjes për çdo artikull të hartohen nga Ndërmarrja e Prodhimit të Veshjeve të Ushtrisë, me analiza analitike të kostos, kurse miratimi i tyre të bëhet nga Ministri i Rendit Publik.
 3. Fondet për prokurimin e veshjeve ushtarake të përballohen nga vetë fondet e planifikuara për çdo vit në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik.
 4. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta